



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

**K Ë R K E S Ë**

**në pajtim me nenin 113, paragrafi 7, të Kushtetutës së  
Republikës së Kosovës, si dhe neneve 46, 47, 48 dhe 49 të  
Ligjit për Gjykatën Kushtetuese**

Lënda nr. KR \_\_\_\_/\_\_\_

Data e pranimit:

*(plotësohet nga Shkrimorja e Gjykatës)*

---

**Formulari të cilin e plotësoni duhet të jetë i lexueshëm**

**I. Paraqitësi i Kërkesës**

(Në vijim plotësoni të dhënat për paraqitësin e kërkesës dhe përfaqësuesit të tij/saj, nëse ka të tillë)

1. Mbiemri..... 2. Emri.....

Gjinia: mashkull / femër

3. Kombësia ..... 4. Profesioni.....

5. Data e lindjes..... 6. Vendi i lindjes .....

7. Adresa e banimit të përhershëm

.....  
.....  
.....

8. Nr. i telefonit ..... E-mail.....

9. Adresa e banimit të tanishëm (nëse ndryshon nga ajo në pikën 7.)

.....  
.....

10. Emri i përfaqësuesit<sup>1</sup> .....

11. Profesioni i përfaqësuesit.....

12. Adresa e përfaqësuesit.....

.....  
.....

13. Nr. i Tel ..... Nr. i faksit .....

<sup>1</sup> Nëse kërkuesi ka caktuar përfaqësues, bashkëngjitni autorizimin e nënshkruar nga kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij/saj.

## **II. DEKLARATA E FAKTEVE**

Ofroni hollësi të qarta dhe koncize mbi faktet për të cilat ankoheni. Paraqitni datat e sakta dhe mundohuni të përshkruani ngjarjet sipas renditjes që kanë ndodhur. Nëse ankesat tuaja kanë të bëjnë me disa çështje të ndryshme (për shembull disa procedura të ndryshme gjyqësore), trajtoni çdo çështje ndaras.

14.

Më datën 20 prill 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit (tani e tutje Ligji), me 56 vota PËR, 30 vota KUNDËR, dhe 4 ABSTENIME.

Neni 14 paragrafi 1 i këtij Ligji, parasheh themelimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit.

Themelimi i një organi të tillë i cili sipas këtij ligji merr një pjesë të kompetencave vetanake (ekskluzive) të Komunës, bie ndesh me dispozitat kushtetuese mbi qeverisjen lokale dhe organizimin territorial.

Neni 14, paragrafi 1, pika 1.2 i Ligjit, në mes tjerash parasheh që në përbërje të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit të jenë nga një anëtar që përzgjidhen nga Bashkësia Islame, Kisha Ortodokse Serbe dhe Kisha Katolike respektivisht.

Një përfaqësim i këtillë i bashkësive fetare në një organ publik bie ndesh me parimin e laicitetit dhe me parimin e neutralitetit në çështjet fetare, dhe në të njëjtën kohë krijon privilegje për disa bashkësi fetare, duke i marginalizuar dhe diskriminuar bashkësitë tjera dhe qytetarët pa orientime/besime fetare.

**III. DEKLARATA E SHKELJES (SHKELJEVE) TË POHUARA TË KUSHTETUTËS DHE/APO INSTRUMENTEVE/DOKUMENTEVE NDËRKOMBËTARE MBI TË DREJTAT E NJERIUT TË CILAT ZBATOHEN DREJTPËRSËDREJTI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Shpjegoni sa më saktësisht që mundeni se cila është ankesa juaj në bazë të Kushtetutës. Cekni dispozitat kushtetuese në të cilat mbështeteni dhe shpjegoni se pse faktet që i keni parashtruar në pikën 3 përbëjnë shkelje të këtyre dispozitave.

15. Ne konsiderojmë se miratimi i Ligjit me këtë përmbajtje shkel Kushtetutën e Kosovës dhe atë nenin 8 (Shteti Laik), nenin 24 (Barazia para Ligjit), si dhe nenin 123 paragrafi 3 (Parimet e përgjithshme) dhe nenin 124 paragrafi 3 (Organizimi dhe funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale).

**Shkelja e nenit 8 (Shteti Laik)**

Neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Shteti Laik) thotë se Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.

Për më tepër, Ligjit për Liritë Fetare në Kosovë NR. 02/L-31 shprehimisht në nenin 5, pika 5.2. parasheh se bashkësitë fetare janë të ndara nga autoritetet publike.

Parimet e laicitetit dhe te neutralitetit në çështjet e besimeve fetare, krijojnë obligim për të gjitha institucionet publike që gjatë ushtrimit të autorizimeve të tyre kushtetuese të ruajnë paanshmërinë si ndaj bashkësive fetare ashtu edhe ndaj koncepteve atesite dhe agnostike, duke i trajtuar në mënyrë të njëjtë edhe të gjitha bashkësitë fetare sikurse dhe konceptet ateiste dhe agnostike.

Po ashtu, institucionet publike nuk duhet të favorizojnë apo të anashkalojnë asnjë person apo kolektivitet të themeluar mbi konceptet e besimit fetar, dhe gjatë gjithë kohës së ushtrimit të autorizimeve kushtetuese duhet të sigurojnë se mbesin neutrale në çështjet e besimeve fetare.

Në çështjen EPPERSON v. ARKANSAS. 1968, Gjykata Supreme e SHBA-së, në mënyrë shumë të qartë ka definuar çështjen e neutralitetit fetar, duke thënë se "Qeveria në demokracinë tonë, shtetërore dhe kombëtare, duhet të jetë neutrale në çështje e teorisë, doktrinës dhe praktikës fetare. Ajo nuk mund të jetë armiqësore ndaj ndonjë feje ose ndaj avokimit to mos besimit fetar;. Dhe nuk mund të ndihmojë, nxis, apo promovojë një fe apo teori fetare përballë

tjetrës apo edhe kundër opozitës militante. Amendamenti i Parë mandaton neutralitetin qeveritar ndërmjet religjioneve, dhe ndërmjet religjioneve dhe jo religjioneve. "

Po ashtu në këtë kontekst, pavarësisht nga fakti se këto trajtojnë më tepër çështjet e ushtrimit të fesë, parimet e vendosura nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, e cila në një mori rastesh ka deklaruar se shteti duhet të mbetet neutral në çështje fetare, duhet të merren parasysh. Duke konsideruar nenin 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut i cili parasheh liritë fetare, Gjykata ka theksuar se parimi i dytë themelor i përshkruar nga ky nen është neutraliteti i shtetit *vis - a vis* religjioneve. Në rastin *Hasan and Chaush*<sup>2</sup> Gjykata për herë të parë theksoi se liria fetare e përmban këtë obligim. Për më tepër, në *Alexandridis v. Greece*<sup>3</sup>, gjykata ka kritikuar rolin e privilegjuar të bashkësive fetare, në këtë rast të Kishës Ortodokse Greke, në institucionet publike.

Duke i përfshirë përfaqësuesit e bashkësive fetare në një organ publik, Ligji shkel parimin e laicitetit dhe të neutralitetit të organeve publike, duke i dhënë disa bashkësive fetare kompetenca në ushtrimin e funksioneve publike. E drejta e vendimmarrjes (rrjedhimisht edhe e vetos) këtyre bashkësive fetare u garantohet përmes Nenit 18. E drejta për ankesë (Moratoriumi) të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, dhe në veçanti Kishës Ortodokse Serbe përmes paragrafit 5. të këtij neni, duke ia mundësuar asaj referimin e çështjeve tek Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM).

Në mënyrë që të sigurohet neutraliteti i shtetit në çështjet e besimeve fetare, është e domosdoshme që përbërja e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit të mos përfshijë anëtar të PËRZGJEDHUR nga bashkësitë fetare, sepse kjo me automatizëm krijon pozitë të privilegjuar për këto bashkësi dhe njëkohësisht i margjinalizon bashkësitë tjera fetare, si dhe qytetarët pa orientime fetare.

#### **Shkelja e nenit 24 (Barazia para ligjit)**

Po ashtu Ligji me një përmbajtje të këtillë, krijon pabarazi të hapur për pjestarët e bashkësive fetare të përmendura në këtë ligj në raport me pjestarët e bashkësive tjera fetare dhe personave që nuk i përkasin asnjë besimi fetar duke shkelur nenin 24 të Kushtetutës i cili thotë se:

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes

---

<sup>2</sup> Eur. Ct. H.R. (Grand Chamber), *Hasan and Chaush v. Bulgaria*, 26 October 2000, para. 62

<sup>3</sup> *Alexandridis v. Greece*, App. No. 19516/06, 2008 Eur. Ct. H.R., § 38

kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike,

Po ashtu, neni 2, paragrafi 1 (Mbrojtja nga Diskriminimi) i Ligjit për Liritë Fetare në Kosovë NR. 02/L-31 thotë se:

“Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar ose i privilegjuar në çfarëdo mënyre në bazë të besimit fetarë, përkatësisë ose jopërkatësisë së një Bashkësie fetare, ose për kryerjen e ceremonive dhe ritualeve fetare.”

Duke i përfshirë përfaqësuesit e vetëm tre bashkësive fetare në Ligj, qartazi këto bashkësi favorizohen kundrejt bashkësive tjera fetare dhe qytetarëve pa orientime të tilla, duke shkelur parimin e barazisë para ligjit të mbrojtur me nenin 24 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

#### **Shkelja e neneve 123 par.3 dhe 124 par.4 (Parimet e përgjithshme dhe Organizimi i Vetëqeverisjes Lokale)**

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Aneksi 5, Neni 4.1.7 thotë qartë se:

“Zona e mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të përcaktohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM-në dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objektet otomane, katolike, laike dhe objektet tjera të rëndësisë së veçantë historike dhe kulturore.”

Për më tepër, rregullimi i kësaj çështjeje me një ligj të Kuvendit të Kosovës paraqet shkelje të autonomisë komunale, e cila derivon nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, (Aneksi 5, Neni 4.1.7) dhe Kapitulli 10 i Kushtetutës së Kosovës mbi Qeverisjen Lokale dhe Organizimin Territorial. Neni 123 i Kushtetutës së Kosovës, paragrafi i tretë përcakton se “Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale”. Neni 4, paragrafi 3 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale përcakton që “përgjegjësitë publike duhet në përgjithësi të ushtrohen nga ato autoritete që janë më afër qytetarit. Bartja e përgjegjësisë në një autoritet tjetër duhet të ketë parasysh gjerësinë dhe natyrën e përgjegjësisë dhe kërkesat për efikasitet dhe ekonomizim.

E drejta e themelimit dhe menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit (e cila derivon nga Propozimi gjithëpërfshirës, Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale), i është marrë komunës së Prizrenit në mënyrë arbitrare dhe nuk është prezantuar asnjë analizë për të dëshmuar nevojën e themelimit të Qendrës Historike të Prizrenit përmes një ligji të Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 17. Kompetencat vetanake, përcakton listën e kompetencave të plota dhe ekskluzive të komunave, ku bën pjesë edhe planifikimi urban dhe rural (pika b). Qendra Historike e Prizrenit është njësi urbane jetësore në kuadër të qytetit të Prizrenit, i cili është në administrim të autoriteteve

të Komunës së Prizrenit. Integriteti dhe autenticiteti i Qendrës Historike kërkon mbrojtje nga devastimet apo shkatrrimet që mund të ndodhin nga zhvillimet bashkohore Të drejtatat dhe obligimet e poseduesve dhe të shfrytëzuesve janë të barabarta dhe të pamohueshme. Në këtë kuart urban, popullata, shfrytëzuesit dhe poseduesit e parcelave janë akter të rëndësishëm. Kërkesat dhe nevojat e tyre mbështeten nga shërbimet e autorizuara komunale dhe shtetërore. Sipas rregullave metodike të konservimit të sipërfaqeve të mbrojtura, me qëllim të orientimit dhe harmonizimit të kërkesave bashkohore dhe ruajtjes së integritetit dhe autenticitetit të Qendrës Historike në Prizren, autoritetet komunale kanë miratuar Studimin dhe Planin e Konservimit. Studim/Plani i Konservimit, i elaboruar në metodologji bashkohore të konservimit dhe zhvillimit të Qendrës Historike, është punuar nga planer të konservimit urban / ekip ndërkombëtar.

Ky Plan, i cili duhet zhvilluar më tej, është platforma e cila determinon normat ligjor për zhvillime bashkohore, duke përfshirë aktivitetet e restaurimeve të monumenteve, mundësit e ndërtimeve me destinacione bashkohore, rehabilitimi i infrastrukturës, sistemi i mirëmbajtjes, ridestinimet dhe adaptimet e ndërtesave për përdorim bashkohor, etj. Në ligjin për Qendër Historike në Prizren, rregullat për zhvillime bashkohore janë përcaktuar duke mos përfillur parametrat e definuar në Studim/Master Plan të Konservimit. Dukuria e mospërfilljes së Planit të Konservimit dhe të krijimit të autoriteteve kontrolluese dhe vendimare jashtë sistemit ligjor të administrimit shtetëror, krijon mundësi që zhvillimet bashkohore në Qendrën Historike të Prizrenit të bëhen në mënyrë jo të duhur, me rregulla dhe kritere joprofesionale, me paragjykime dhe diskriminime. Këto veprime klasifikohen si të padrejta, të cilat në mënyrë direkte do të cenojnë integritetin dhe autenticitetin e trashëgimisë kulturore dhe të drejtat njerëzore.

### **Shkelja e parimeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore**

Gjithashtu, parimet dhe normat e përcaktuara në këtë ligj janë në kundërshtim me sistemin e mbrojtjes ligjore dhe të administrimit të pronave të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe ligjin bazë nga i cili derivojnë (nenet 10 dhe 11). Këto mangësi bëjnë që këto ligje të janë të pazbatueshme dhe të kontestueshme. Pronat e larëmishtme të trashëgimisë kulturore të Kosovës vlerësohen si potencial dhe atribut fisnik i mjedisit jetësor dhe i njerëzimit, pa prejjudikime të pronësisë kulturore, të poseduesit apo të shfrytëzuesit. Ky potencial kërkon respekt dhe duhet të trajtohet, shfrytëzohet dhe prezantohet sipas parimeve dhe praktikave bashkëkohore, pa dallim të përkatësisë etnike apo religjioni, të periudhës historike, të krijuesit, të poseduesit, të shfrytëzuesit apo të gjendjes teknike të tij.

Pronat e trashëgimisë kulturore të specifikuar në Pako (Aneksi V, neni 4) janë pjesë integrale e pasurisë kulturore të Republikës së Kosovës. Sipas normave dhe praktikave ndërkombëtare, mbrojtja e pronave të trashëgimisë kulturore të Kosovës, duke përfshirë përmbushjen e detyrave të parashtruara në Pako (Neni 4, Aneksi V; Neni 1.4 Aneksi XII) i përkasin shtetit. Mbrojtja e tyre bëhet në mënyrë aktive, duke i rehabilituar dhe përshtatur për shfrytëzime bashkohore. Këto prona të klasifikuar si sipërfaqe të mbrojtuar

duhet përfshirë në Planin Hapësinor dhe planet zhvillimore të Komunave. Përbushja e detyrave bëhet nëpërmjet mekanizmave të tij ligjor, administrues dhe finacimi në sistem dhe me Politikë Shtetërore të integruar (National Integrated Cultural Heriatge Policy). Republika e Kosovës, në funksion të ndërmarrjes së masave efektive në relacion me identifikimin dhe mbrojtjen e pronave të trashëgimisë kulturore ka të zhvilluar platformë primare legjislative dhe sistem të administrimit me institucione në linjë të integruar (Ligji për Trashëgimi Kulturore/Nr.02/L-88/2006; Ligji për Planifikim Hapësinor/Nr. 2003/14, Shema, 1, 2, 3,4). Plotësimi i saj duhet bërë edhe me mekanizma tjerë ligjor si Standardet Profesionale, korniza intsitucionale në sistem të integruar, sistemi i licencimit, Ligji për përcaktimin e Zonave dhe Sipërfaqeve të Mbrojtura me potencial të trashëgimisë kulturore, etj.

Përcaktimi i parametrave të mbrojtjes së pronave të trashëgimisë kulturore bëhet duke krijuar oaza të izoluara nga zhvillimet bashkohore jetësore dhe të shkëputur nga sistemi i administrimit shtetëror. Sipas parametrave të këtij ligji, me qëllim të mbrojtjes së autenticitetit dhe integritetit nga zhvillimet bashkohore, të gjitha pronat e trashëgimisë kulturore të specifikuara në Pako me automatizëm themelohen si Zona të Vecanta të Mbrojtura. Ndërkaq, pronat tjera të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës (peizazhet kulturore, lokalitet arkeologjike dhe arkitekturore) eliminohen nga kjo e drejtë ligjore. Gjithashtu, përcaktimi i kufinjëve dhe klasifikimi i sipërfaqeve të vecanta të mbrojtura me ndalesat e aktivitetëve janë bërë në mënyrë jo të duhur, pa asnjë eksperizë, studim, dokumentim apo plan të mirëfillt konservimi, duke anashkaluar kriteret e përcaktuara me ligjislacion primar të Republikës së Kosovës. Këto veprime që në mënyrë arbitrare dhe selektive bëjnë vlerësimin dhe përcaktimin e pronave të trashëgimisë kulturore për mbrojtje janë në kundërshtim të plotë me rregulativin e Kosovës për mbrojtjen e pronave të trashëgimisë kulturore, (Ligji për Trashëgimi Kulturore/Nr.02/L-88/2006; Ligji për Planifikim Hapësinor/Nr. 2003/14).

Në konceptin e përmbajtjes së këtij tij, Qendra Historike e Prizrenit do të funksionojë si Njësi Administrative e Veçantë, duke u bazuar në statusin ligjor të si 'Zona të Veçanta të Mbrojtura'. Preambulla e ligjit, mënyrat e përcaktimit të statusit të teritorrit si njësi administrative e veçantë, nocionet, mekanizmat e menaxhimit të zhvillimeve të këtij territori dhe përcaktimit të ndalesave, janë në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare dhe normat e sistemit ligjor dhe të administrimit të pronave të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës.

Përmbajtja e këtij ligji është shpërputhje të plote me:

- normat dhe parimet e përcaktuara me sistemin e mbrojtjes ligjore për planifikim dhe administrim të pronave të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës (Ligji për Trashëgimi Kulturore /Nr. 02/L-88/2006; Ligji për Planifikim Hapësinor/Nr. 2003/14)
- parimet, praktikën dhe normat ndërkombëtare për mbrojtje të qendrave historike; (Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore, UNESCO, Paris 1972; Karta për



mbrojtjen dhe konservimin e qyteteve historike dhe sipërfaqeve urbane, ICOMOS, Washington 1987; Udhëzuesi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore, Bernard M. Feilden & Jukka Jokilehto, ICCROM, UNESCO, ICOMOS, 1998, etj).

**Formulari të cilin e plotësoni duhet të jetë i lexueshëm**

**IV. DEKLARATA SIPAS NENIT 113, NENIN 7 TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 49 TË LIGJIT PËR GJYKATËN KUSHTETUESE**

Ofroni informatat e nevojshme që dëshmojnë se i jeni përmbajtur afateve kohore dhe rregullave për shterimin e mjeteve juridike. Për secilën ankesë informatat duhet të ofrohen ndaras.

16. Vendimi final

Gjykata apo autoriteti që mori vendimin

--

Vendimi nr.

Data e miratimit

Data kur ju është dorëzuar vendimi

--

--

--

17. Vendimet tjera (listoni në renditje kronologjike, duke paraqitur datën, gjykatën apo autoritetin që ka marrë vendimin)

	Gjykata/organi që mori vendimin	Vendimi nr.	Data e miratimit
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

18. A ka apo a ka pasur në dispozicion ankesë apo mjet tjetër juridik të cilin nuk e keni shfrytëzuar? Nëse po, shpjegoni pse nuk e keni shfrytëzuar.

**Formulari të cilin e plotësoni duhet të jetë i lexueshëm**

**V. DEKLARATË E LËNDËS SË KËRKESËS**

Deklaroni shkurtimisht se çka dëshironi të arrini përmes  
parashtrimit të kërkesës suaj në Gjykatë

19.

Përmes kësaj kërkesë pretendojmë që në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese ti shqyrtojë të gjitha faktet e paraqitura në mënyrë objektive dhe përfundimisht të jep një vendim në lidhje me kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar të Kuvendit.

**Formulari të cilin e plotësoni duhet të jetë i lexueshëm**

**VI. LISTA E DOKUMENTEVE**

Shtoni listën e të gjitha aktgjykimeve dhe vendimeve të referuara në pikën IV si dhe dokumentet tjera të cilat dëshironi që Gjykata t'i merr në konsideratë si dëshmi (transkriptet, deklaratat e dëshmitarëve, etj).

Gjithashtu duhet t'i shtoni edhe kopjet e plota të këtyre dokumenteve.

**Asnjë dokument nuk do të ju kthehet. Prandaj, është në interesin tuaj që të parashtroni kopje, jo origjinale.**

Listoni të gjitha dokumentet e bashkëngjitura.

1.	
2.	
3.	
4.	
5.	
6.	
7.	
8.	
9.	
10.	

Përfshini kopjet e të gjitha vendimeve

**Formulari të cilin e plotësoni duhet të jetë i lexueshëm**

**VII. GJUHA ZYRTARE**

Cilën gjuhë zyrtare dëshironi të përdorni në komunikimet e juaja me Gjykatën Kushtetuese?

- Shqip  
 Serbisht

**VIII. FSHEHTËSIA**

A dëshironi që Gjykata Kushtetuese të marrë në konsideratë mbrojtjen e identitetit tuaj?

PO

JO

Megjithatë i mbetet Gjykatës Kushtetuese të vendos mbi këtë në bazë të argumenteve që ju i paraqisni lidhur me kërkesën për mbrojtjen e identitetit tuaj.

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i parashtruesit të  
kërkesës apo përfaqësuesit të  
tij/saj  
(vula<sup>4</sup>)

\_\_\_\_\_  
Vendi dhe data

Ky formular duhet të dorëzohet-dërgohet në adresën e mëposhtme:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës  
Qyteza Pejton, ish ndërtesa e TMK-së  
10000 Prishtinë, Kosovë.

\_\_\_\_\_  
<sup>4</sup> Kërkohe në rast të personit juridik